



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2025-001

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala I.R., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, B.A., më datë 11.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e palës I.R., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, B.A.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme më datë 13 janar 2024 përmes Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka pranuar ankesën e palës I.R., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, B.A., për shqyrtim të pretendimeve tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, B.A., ka paraqitur ankesën e tij me pretendimet se gjyqtari me rastin e vendosjes në lëndën e tij gjyqësore ka keqpërdorur nenet, i cili sipas tij në seancën e fundit pretendon se e kishte pyetur disa here që t'i kërkoj falje gruas së tij lidhur me rastin për të cilin ai akuzohej duke u shprehur në ankesën e tij se gjyqtari e ka dënuar në emër të popullit mbi bazën e shpifjeve të prokurorit të rastit M.M..

Lidhur me pretendimet e palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka analizuar dhe shqyrtuar deklaratën e gjyqtarit B.A., lidhur me këtë rast.

Në deklaratën e tij, gjyqtari A. ka deklaruar se për shkak se nuk qëndron pretendimi i palës se ia ka kërkuar disa herë që të kërkoj falje por që kërkim falja ka ardhur pasi që i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe gjykata ka aprovuar fajësinë e tij dhe në kuadër të rrethanave për matjen e dënimit i pandehurit ka pohuar se i kërkon falje të dëmtuarës dhe se dëshiron të vazhdoj jetën bashkëshortore me të. Tutje, gjyqtari i apostrofuar, ka elaboruar rrjedhën e çështjes penale dhe ka sqaruar se i njëjti brenda afatit ligjor ka vendosur lidhur me çështjen penale me aktgjykimin P.nr. 3309/23 i datës 23.10.2023, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për veprën penale *“dhuna në familje”*.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së gjyqtarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës si dhe nga të gjitha pretendimet e palës ankuese, rezulton se kemi të bëjmë me shprehje të pakënaqësisë rreth vendimit i cili është marr gjatë procedurës, nga ana e gjyqtarit të çështjes. Megjithatë, nuk ka një përshkrim të qartë dhe faktik që të mbështesë pretendimet se gjyqtari ka kryer shkelje në këtë rast.

Në këtë drejtim, si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes se gjyqtarëve dhe vendimit të marrë nga gjyqtari i çështjes, ngase gjyqtarët por edhe Kryetari i Gjykatës janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre respektivisht në punën e tyre.

Bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtar”*, në rastin konkret konsideroj se veprimet e gjyqtarit në raport me lëndën konkrete nuk përbëjnë bazë për dyshim për ndonjë sjellje të mundshme disiplinore.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e gjyqtarit B.A., nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.